



01/Nr. 2127/2020  
Data: 17.03.2020

## PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e dytë -II- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 27.02.2020 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Menduh Vlashi (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), Edon Curri (Drejtor për Administratë), Medina Imishti (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Sevime Laçi (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Kujtim Dernjani (Kryesues i Komisionit të Aksionarëve), Ajete Berisha (Udhëheqëse e Personelit), Bajrush Laçi (Shef i Zyrës Ligjore), Xhevedet Bushi (Shef i Zyrës së Prokurimit), Ibrahim Axhami (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), Bashkim Sopa (Zyrtar për Informim), Përfaqësuesit e OSB-së. Kryesuesi i kuvendit pasi konstataoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i informatës mbi raportin e punës së kryetarit të komunës për vitin 2019.
3. Miratimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2019.
4. Miratimi i propozim vendimit për rritjen e buxhetit nga të hyrat vetanake për vitin 2019.
5. Miratimi i propozim vendimit për bartjen (rialokimi) e buxhetit të paspenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual.
6. Miratimi i propozim vendimit për miratim dhe realizimi të projektit kapital "Kanali i myllur për ujërat atmosferike " Seqishtë.
7. Miratimi i raportit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2019.
8. Informatë mbi raportin vjetor 2019 të NPL Pastrimi Sh.A.
9. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### U MIRATUA RENDI I PUNËS

#### 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Isni Bushi** thekson:- ka fjalë që nuk shënohen në procesverbal që ndoshta janë fjalë fyse dhe nuk e di ku është problemi për shkak se duhet të dihet nëse unë përdori fjalë fyse. Dikush ndoshta këtë proces e lexon dhe publikohet në veb faqe të komunës. Është mirë ta dinë secili se kush çka po fol dhe çfarë fjalë po përdorë.

**Kryesuesi** thekson:- nëse ke vërejtje në diskutimin tënd mundesh me plotësuar.

**Isni Bushi** thekson:- drejtori drejtorisë për arsim ka kërkuar nga këshilltari që ta tërheqë fjalën e cila u potencua për çështje të diplomave. Kërkoi të shënohet fjala e z.Mefail Suma te mbledhjes se kaluar se unë mendoj që opozita është konstruktive se keni nevojë dhe kisha potencuar se me drejtor edhe krejt merrni diplomat dhe vnojani kijeve në brina se asgjë nuk janë tu ju vlejtë. Të shënohet fjala e Drejtorit të Drejtorisë për Arsim Kulturë Rini dhe Sport se edhe në seancat tjera dhe në këtë seancë por përdoret fjalor fys dhe unë prita prej kryesuesit për me u a tërhequr vërejtjen dhe nuk është mirë me i fyri persona për shkak se jeni të zgjedhurit e popullit sepse u potencua nga njëri prej këshilltarëve që vnojani kijeve diplomat në brina.

**Florim Shkreta** thekson:- edhe në mbledhjen e kaluar kam kërkuar që të na dërgohet procesverbali i mbledhjes së KKSBS-së dhe i bordit të drejtorëve. Nëse ndonjë propozim votohet apo nuk votohet a ekziston mundësi me u ditë se kush është kundër dhe kush është për sepse unë votoj kundër e nuk dihet që kam votuar.

**Mefail Suma** thekson:- e përkrahi z. Florim Shkreta rreth shënimit të votimit se nëse është opozita kundër duhet të shënohet për shkak se e ka atë kuptimin kur opozita është kundër dhe ka domethëniet.

**Akif Shkreta** thekson:- është mirë që në të ardhme me u siguruar pajisjet dhe votimi të bëhet në mënyrë elektronike e cila regjistrohet në formë raporti dhe nuk ka asnje problem.

**Kryesuesi** thekson:- duhet të respektohet rregullorja për shkak se parashev që mos me u përdorë fjalët fyse dhe është mirë me ju përbajtur. Prosesverbalet janë në faqe zyrtare dhe mund t'i shikoni. Nëse kërkohet me emra besoj që ne dalim jo seriozë. Nëse jeni dakord në këtë vit nuk bëjmë asnjë vizitë dhe me ato mjete që janë të planifikuar e autorizojmë ekzekutivin për me bërë votimin elektronik. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit 14 për 1 kundër (nga opozita).

#### MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

## 2. Shqyrtimi i informatës mbi reportin e punës së kryetarit të komunës për vitin 2019.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Rufki Suma** thekson:- janë shënuar aktivitete të cilat i kemi pasur vitin e kaluar. Në pjesën e parë janë shënuar marrëveshjet e bashkëpunimit të cilat i ka pasur kryetari i komunës, takimet dhe aktivitete më të rëndësishme dhe secila drejtori e ka reportin e vetë në hollësi. Nëse keni ndonjë pyetje apo paqartësi brenda reportit mund të parashtroni.

**Mefail Suma** thekson:- çdo herë kur kemi diskutim për reportin e punës së kryetarit të komunës na është afruar informatë dhe kam kërkuar që të bëhet shqyrtim që së paku të na ipet e drejta e diskutimit sepse rreth informatës nuk kemi se çka diskutojmë. Është shënuar shqyrtimi i informatës mbi reportin por është mirë që të hiqet fjala mbi reportin për shkak se me statut është që kryetari i komunës raporton para kuvendit të komunës e nuk informon. Është potencuar që shumë kryetarë të komunave nuk informojnë por në statut të komunës e keni që kryetari i komunës raporton para kuvendit të komunës për punën e vet, me që ajo nuk po bëhet kërkoi që të ndryshohet statuti i komunës dhe të paraqitet këtu si informatë për shkak se neve si asamblistë po na merret e drejta e debitimit dhe e vendim marries. Sa përket projektit për ndërtimin e shtëpisë së kulturës kur është shpallur tenderi dhe në momentin kur është nënshkruar kontrata është dashur të na paraqitet një pamje e jashtme e projektit të shtëpisë së kulturës. Kontraktuesi i këtij projektit a i kryen punët vetë apo është ndonjë nënkontraktues sepse zakonisht tenderët kur fitohen punët nuk i kryen kontraktuesi por e dërgon një nënkontraktues të vetin. Kush e kontrollon ndërtimin e objektit. A ka person profesional që mund ta kontrollojnë ndërtimin e objektit. Sa është shuma e mjeteve financiare e tenderuar. Në sa faza do të kryhet ndërtimi i këtij objekti. A ka afat se kur përfundon ndërtimi i objektit dhe nëse kontraktuesi nuk i kryen punimet e objektit me kohë a ka ndonjë masë për ndëshkim. Si do ta ketë pamjen objekti i shtëpisë së kulturë dhe sa metra katrorë do t'i ketë funksionale. Sa salla janë të planifikuar, lloji i sallave dhe sa zyra. Sa kompani kanë aplikuar në këtë tender. Sa është diferenca e çmimeve të tenderuesve.

**Samire Curri** thekson:- ndërtimi i fushës së futbollit afër shkollës së mesme “Dardania” që komuna ka financuar në shumë prej 100 000 € e që si projekt i përbushë nevojat e nxënësve dhe të rinjve të komunës sonë për manifestime të ndryshme sportive. Projekti i ndërtimit të shtëpisë së kulturës në Han të Elezit i cili planifikohet të ndërtohet brenda dy viteve dhe shpresoj që do të kryhen punimet së shpejti dhe do të na shërbejë për debatet publike, manifestime publike të ndryshme. Në kuadër të këtij projekti propozoj që të ju mundësohet qytetarëve një bibliotekë siç është në komunën e Kaçanikut që biblioteka funksionon brenda hapësirës së Shtëpisë së Kulturës.

**Sabrije Krasniçi** thekson:- ishte 21 vjetori i rënies së Dëshmorëve Gafurr e Driton Loku dhe nuk është bërë asnjë organizim pavarësish mundësive të ndonjë manifestimi së paku është dashur një vizitë te lapidari i Dëshmorëve sepse pas kësaj date është edhe manifestimi ~~edhe~~ për Dëshmorët e tjerë dhe nëse për ato organizohen ndonjë manifestim e për këta nuk është organizuar atëherë është shumë keç. Manifestimet dhe vizitat që janë nuk është mirë me i anashkaluar për shkak të kontributit që kanë dhënë dhe fal kontributit të tyre ne jemi sot. Drejtoria e arsimit ka ndërtuar fusha të sporti ka bërë kabinete të ndryshme dhe ka bërë një punë të mirë, por krahas kësaj është mirë me u marr me ligjérata të nxënësve nëpër shkolla sepse janë tu e marr një sjellje shumë të keqe dhe nuk janë në vlera normale dhe duhet të organizohen ligjérata nga policia dhe shëndetësi. Duhet të ketë më shumë trajnime të mësimdhënësve siç kanë filluar në shkollën fshatit Paldendicë por të vazhdohet edhe nëpër shkolla të tjera. Te Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë shënon për fëmijët e lindur në vitin 2019 por nuk është shënuar asnjë fëmijë dhe është mirë të përmirësohet se ndoshta është gabim teknik. Drejtoria për Bujqësi si mendon me informuar banorët që me pasur më shumë aplikime për grande të ndryshme për shkak se viteve të tjera nuk ka pasur shumë.

**Akif Shkreta** thekson:- janë disa të dhëna për disa data të shënuara në komunën e Hanit të Elezit, andaj Drejtorisë për Arsim dhe Kulturë i kërkojë që të bëjë një listë të festave zyrtare të cilat janë në nivel të shtetit dhe po ashtu edhe datat e shënuara të komunës së Hanit të Elezit të ua përcjellë institucioneve sepse mund të bëhen aktivitete të ndryshme siç ka bërë shkolla e mesme “Dardania”.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- për këtë pik të rendit të ditës kam diskutuar edhe në KPF dhe procesverbalin e kanë pranuar të gjithë nga sekretaria e kuvendit dhe vërejtjet të cilat janë dhënë ishin ndryshuar. Kërkoj sqarim për çështjen e rregullit të bravës së veturës është dashur me specifikuar më në detale. Diskutuan për shtimin e kapacitetit të ujit për të cilin janë investuar afër 30 000 € dhe nënkyetari i komunës ma dha një përgjigje por më shumë ke teorike se është shtuar kapacitetit i ujit, mirëpo ne nuk e dimë sa ka qenë kapaciteti i ujit dhe sa është shtuar me këto investime dhe do të ishte mirë me i specifikuar. Statistikat që janë bërë me CA në QKMF është shqetësuese sepse shumica ishin me CA pulmo që kjo e nënkupton se është çështja e ambientit dhe e ujit. Është mirë që kjo çështje të merret më seriozisht dhe të merren iniciativa nëse ka institut të veçantë për hulumtimin e këtyre problemeve se prej nga vjen kjo sëmundje në mënyrë që me marr masa.

**Florim Shkreta** thekson:- procedurat me vlerë mbi njëmijë euro kërkoj një sqarim më shumë te rregullimi i trotuarit për këmbësorë për biçiklistë Dheu i Bardhë- Shkolla filllore “Ilaz Thaçi”. Te vlerat nën një mijë euro për publikimin në vebfaqe për aktivitete e komunës dhe në Tv Dielli. Furnizim me tavolina për shkollën e mesme “Dardania”. Ngritja e pllakave përkujtimore vërehet së është bërë punë më shumë dhe vlerat janë më të vogla . Te zhvillimi ekonomi shënon që janë hapur 35 biznese të reja në komunën tonë dhe kërkoj sqarim ta dijë që a janë vendore apo ka edhe jashtë komunës sonë.

**Isni Bushi** thekson:- te drejtoria për Zhvillim ekonomik është potencuar se organizata HELP te projekti “Empoëer” që ka vlerën rreth 47,905.85 € dhe komuna ka particar afër 20 %. Nga ky projekt janë përzgjedhur 19 përfituesë dhe a janë persona që janë përfitues e që e kanë zgjerura biznesin apo janë persona që për herë të parë e zhvillojnë këtë biznesë. U potencua nga parafolsja fëmijët me sjellje jo normale dhe mu dukë pak ofenduese sepse kemi ndoshta fëmijë me sjellje jo normale por nuk janë krejtë se e kemi psikologen që merre por me potencuar me sjellje jo normale nuk është në rregull për shkak se nuk e di a është në rrjedha vetë apo e ka me të të dëgjume këtë çështje. Dje në orën e parë është diskutuar për këtë sëmundjen nga koronaviruesi sepse na është sugjeruar prej drejtorisë. Është mrië me ju bërë vizitë varrezave dhe nuk është mirë me u harruar dhe vizita kemi bërë por shumë pak kemi parë asambleistë që kanë dalë për vizit dhe me u

bërë propozim pse nuk shkojnë po më doket pak si absurde sepse për ditën e pavarsisë nuk marrim pjesë dhe duhet ta shikojmë pesrsonalishtë si kuvendar a marim pjesë apo jo dhe nëse na si anëtarë të kuvendit nuk marrim pjesë si mund të japim vërejtje kur na vet nuk marrim pjesë.

**Sabrije Krasniqi** thekson:- e potencove që fjalë fyese por unë nuk potencova fjalë fyse jo normal fëmijët për shkak se mundem me potencuar me sëmundje mendore por fjala jo normale nuk e pata në atë aspekt por e pata në atë aspekt se ty si mësimdhënës ndoshta e sheh normal një fëmijë nëse përdorë drogë apo në qoftë se një fëmijë rrinë udhëve dhe nuk hynë në mësim koka fëmijë normal. Unë e pata për këto sjellje e jo për fëmijët jonormal që janë me sëmundje mendore sepse kisha potencuar në atë aspekt. Sa i prektë dëshmorëve për shkak tyre ne jemi këtu na sot dhe nuk kemi shumë dëshmorë që të paktën nuk mundemi me shkuar dhe me i vizituar. Është mirë sepse këtë ditë e kanë dhe nëse shkon i viziton nuk është asgjë, mirëpo a marr pjesë unë apo jo për festa të ndryshme është e drejtë e imja për shkak se unë kam obligime dhe është punë e imja se a marr pjesë apo nuk marr.

**Isni Bushi** thekson:-sa i përket asaj që potencove se a janë normal ata të cilët përdorin drogë kisha kërkuar edhe nga ti që nëse i dinë personat sepse unë nuk i dijë dhe është mirë të flitet me emra nëse i dini. Nëpër shkolla është bërë kontroll dhe nuk është gjetur asgjë përvëç disa telefonave dhe nëse dihet janë organet që merren me atë çështje.

**Teuta Shkreta** thekson:- u përmend çështja e psikologëve me sa e dijë unë në shkolla nuk kemi psikolog dhe logopedia nuk merret me psikologji.

**Sabedin Hasallari** thekson:- kemi një rritje të të hyrave vetanake prej 112 % , kërkoi sqarim se si ka ardhur kjo rritje. Drejtoria ka shënuar që kemi bërë vizita nëpër shkolla por nuk janë cekur sa vizita dhe te të hyrat emergjente është një diferencë e madhe është mirë të na ipet sqarim.

**Rufki Suma** thekson:-ju e dini që raporti i kryetarit të komunës nuk miratohet por kryetari i komunës informon për punën, pavarësisht a potencohet shqyrtim apo informim ata që dashtë me potencuar e shprehët , mirëpo nëse kryesuesi do tu a ndalonte fjalën për me diskutuar atëherë mund të potencojmë që termi qon peshë por diskutimi është bërë. Sa i përket miratimit ligji e parashevë për shkak se është diçka që ka shkuar. Statuti e përcakton raport por nuk nënkuftohet raport i aktiviteteve por raporti financiarë i shpenzimeve për të cilin raportojmë çdo tre muaj dhe miratohet në kuvend. Raporti financiarë është obligim dhe i cili do të diskutohet pas kësaj pike të rendit të punës dhe miratohet çdo herë, ndërsa aktivitet janë vetëm njofitim. Çdo projekt që e përpilojmë kemi kodin buxhetorë për përpilimin projektit dhe shpallim tender për me përpiluar projektin dhe pasi të përzgjidhen në bazë të tenderit e që kemi vërejtje edhe ne si komunë për shkak se nuk kemi mundësi asnjë herë me marr një inxhinier që është i mirë se me ligji është paraprë procedura e tenderimit dhe konkurojnë më të dobët dhe kemi probleme vazhdimisht. Në momentin që hartohet projekti i dozohet zyrës së prokurimit për me shpall tenderin për ndërtimin e objektit. Faza e parë e objektit të ndërtimit të shtëpisë së kulturës nënkupton ndërtimin e vrazhgët të objektit. Faza tjeter është fasadimet dhe pajisja e shtëpisë së kulturës me gjërat e domosdoshme për punë. Çdo projekt kur shpallet projektuesi merr për obligim me paraqitur në formë të vizatimit në fotografji. Ata të cilët duan me parë është te shtëpia e kulturë dhe mund të shihet pamja se si do ta ketë , kurse shënimet interne janë çështje e projektit dhe ata të cilat duan mi parë mund të parashtrojnë kërkësë zyrtare drejtorisë së urbanizmit. Shuma e tenderit është publike se sa ka kushtuar dhe dihen çmimet sa ishin të planifikuara dhe sa ka kushtuar. Bibliotekë do të ketë por edhe sallë leximi dhe zyre të mjastueshme edhe për aktivitet kulturore. Komuna i ka festat zyrtare dhe festë zyrtare e komunës është 11 qershori dhe 29 gushti dita e dëshmorëve dhe krejt tjerat janë përkujtime festa memoriale. Datën 26 shkurt asnjë herë nuk e ka shënuar komuna e Hanit të Elezit por çdo herë i ka mbështetur shoqatat e daluara nga lufta. U përmend 21 shkurti duhet ta dini se dallon përvjetori i rregullt me vitet jubilare për shkak se vit jubilar ishte viti që shkoi që i kemi shënuar të gjitha ditët e dëshmorëve dhe ka pasur dekorime. Mirë është me i vizituar pavarësisht a është festë apo nuk është. Kur është organizimi i komunës kemi bërë edhe festa zyrtare, mirëpo shumë herë e kemi bërë njofitim publik dhe ata të cilët duan me ardhur mund të vijën , e nëse organizohet në sall ndonjë mbledhje atëherë dërgohen ftesa. Për me u ndërruar brava e veturës duhet të i nderohet komplet sistemi i cili ka kosto por varet prej llojit të veturës. Sa i përket investimeve të ujit nuk ka pasur shtim të kapaciteteve të ujit por vetëm pusetat janë ndërruar. Janë bërë edhe dy shpime që janë në pesë

litra në sekondë. Sa i përket projektit të shtegut për çiklistë dhe këmbësor vetëm asfalti nuk është shtruar për shkak se Ministria e Infrastrukturës ka premtuar që do ta shtron me asfalt në kuadër të projekteve të magjistrales. Çdo herë kemi pasur kontrata për publikimet më herët e kemi pasur me Kosovapresin kurse tash e kemi me TV Diellin për manifestimet e ndryshme. Sa i përket furnizimit me tavolina për shkollën e mesme "Dardania" tavolinat janë blerë dhe çmimet i kanë. Për projektin e pllakave përkujtimore i kemi planifikuar afér 80 000 € mirëpo ofertat kanë ardhur më të vogla se sa i kemi menduar dhe mjetet financiare të mbetur me ridestinim janë dedikuar në pika tjera. Sa i përket bizneseve të reja me organizatën Hellp që janë 19 biznese të reja dhe komuna ka participuar me 25 % dhe 25 % personi që ka qenë përfitues, ndërsa 50 % ka participuar organizata në fjalë. Krahas bizneseve të reja ka edhe zgjerime të veprimtarisë. Të hyrat vetanake janë për shkak se ju është bërë vërejtje bizneseve dhe tatimit në pronë shumica e qytetarëve i ka kryer obligimet e veta dhe obligimet të cilat i kanë pasur borxh ndaj komunës dhe për atë është tejkaluar.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- kryetari i komunës potencoje që është ndërruar kompletnë i bravës dhe kuptohet që është sistem por është dashur të emërohet ndryshe. Në KPF nën kryetari i komunës ka potencuar se është shtuar kapaciteti i ujit dhe kryetari potenco që nuk është shtuar kapaciteti sepse nuk ka qenë qëllimi i shtimit dhe duhet të përmirësohet.

**Medina Imishti** thekson:- ka shumë dallime te emergjencia për shkak së është 132 me 11 438.00 dhe i njëjti dallim është edhe te kartoteka. Vitin e kaluar i kemi shënuar kompletnë shërbimet te kartoteka dhe si emergjencë i kemi lënë vetëm rastet të cilat ne i kemi përcjellë për në Ferizaj dhe unë kam kërkuar se të gjitha shërbimet që kryhen pas orës pesëmbëdhjetë të jenë te emergjencia sepse deri në ora pesëmbëdhjetë punohet në mjekësi familjare dhe pas orës pesëmbëdhjetë si emergjencë. Është bërë një vizitë e përgjithshme nëpër shkolla ju është bërë 1251 nxënësve të cilët janë kontrolluar për gjatësi, peshë, higjenë dhe në muajin nëntor e kam dërguar raportin detal të cilin e ka bërë stafi.

**Sevime Laçi** thekson:- janë 35 biznese të reja për arsyet se kanë ndikuar grandet. Prej komunës së Hanit të Elezit janë 33 persona që ishin përfitues dhe 2 biznese janë prej komunave të tjera. Përfituesit janë 13 biznese të reja dhe gjashtë biznese janë që kanë qenë ekzistuese. Faturimi i të hyrave është 85,086.60 € ndërsa inskasimi për vitin 2019 ka qenë në shumë prej 95,276.40€ apo 111.98%.

**Zaim Bela** thekson:- komuna për çdo vit bënë thirrje publike për subvencione dhe ata të cilët aplikojnë të gjithë kanë marr. Është mirë me ju ndihmuar edhe më shumë por aq kemi mjete financiare.

**Kujtim Dernjani** thekson:- sa i përket pyetjes që u parashtrua për lindje të fëmijëve, drejtoria jonë merret me rastet mortore dhe bënë pagesën e shpenzimeve të varrimit, ndërsa pagesa për lehoni bëhet nga zyra e kryetarit të komunës.

**Menduh Vlashi** thekson:- ne jemi duke u munduar me gjet ekspertë vendorë apo ndërkombëtarë që sa më shumë të kemi ligjérata me mbajt me mësimdhënës në aspektin profesional dhe në aspektin edukativë. Si drejtori e kemi listën e festave shtetërore, kurse festa komunale i kemi dy dita e çlirimt dhe dita e dëshmorëve. Data 26 shkurti nuk është festë zyrtare por realisht çdo herë i kemi shënuar dhe drejtoreve të shkollave ua kam përcjell me imiell adresë që ora e parë e mësimit ti kushtohet 26 shkurtit dhe po ashtu edhe për korona virusin ua kam përcjell për sepse ka qenë sugjerim prej ministrisë. Në shkollat e komunës së Hanit të Elezit nuk kemi psikolog as logoped por punëtorja që është pranuar është si asistente për fëmijët me nevoja të veçanta.

**Mefail Suma** thekson:- materiali për këtë pikë na është dërguar raporti i punës së kryetarit të komunës për vitin 2019, ndërsa në rend të ditës është shqyrimi i informatës mbi raportin e punës së kryetarit të komunës dhe duhet ta kemi të qartë se a po shqyrtojmë raport apo po shqyrtojmë informatë. Nëse shqyrtojmë informatë duhet të jetë shqyrimi i informatës për punën e kryetarit të komunës, pse me u shënuar edhe informatë edhe raport. Në kompetencat e përcaktuar me statut një ndër to është edhe miratimi i punës së raportit të kryetarit të komunës dhe nëse e shqyrtojmë si informatë ne nuk miratojmë raport. Kërkoi sqarim ta dijë se a e miratojmë raportin e kryetarit të komunës apo nuk e miratojmë.

**Kryesuesi** thekson:- është shumë e thjeshtë dhe e qartë se kryetari i komunës është tu informuar mbi reportin e punës për vitin 2019. Më herët është miratuar reporti, mirëpo tash nuk miratohet reporti dhe për atë është lënë informatë mbi reportin e punës.

**Bajrush Laçi** thekson:- kjo çështje është sqaruar shumë herë dhe sa i përket kësaj çështje ju si anëtarë i kuvendit ishit në komision për hartimin e planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2020 dhe vetë e keni bërë një planifikim dhe i keni përcaktuar pikat se çka keni me diskutuar dhe shqyrtim i informatës vet e keni bërë si anëtarë të kuvendit dhe e keni miratuar. Kjo është vetë ju që e keni kërkuar për shkak se ka qenë vetëm informatë e kryetarit të komunës për reportin. Tash për tash jeni duke folur për informatë e jo për report dhe reporti i cili thuhet që miratohet është report ekonomiko financiarë dhe është tjetër çështje dhe miratohet çdo tre muaj. Te neni 40 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale shënon që për shumë pika që duhet të miratohen mirëpo nuk shkruan se a është plan i kryetarit të komunës apo report sepse shënon plan dhe report e nuk është cekur. Ne kemi kërkuar interpretim ligjorë për këtë çështje në Ministri të Pushtetit Lokal ata janë përgjigjur se nuk duhet të miratohet, ndërsa pika tjetër potencon që duhet të miratohet reporti ekonomiko financiarë i kryetarit të komunës. Në statut nuk potencohet që duhet të miratohet reporti vjetorë i kryetarit të komunës.

**Mefail Suma** thekson:- informatë është që na vetëm mund ta lexojmë dhe nuk mund të parashtrojmë pyetje dhe nëse është shqyrtimi i informatës është çështje tjetër, shqyrtimi i reportit është tjetër çështje. Është mirë që të lexoni pak më shumë sepse kuvendi i komunës nuk merret me informata sepse në rregullore të punës potencohet.

**Kryesuesi** thekson:- zyra ligjore e sqarojë këtë çështje dhe tregoj se kanë kërkuar interpretim prej Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe ne nuk mund të japim sqarime të tjera.

**Florim Shkreta** thekson:- sa i përket TV Diellit kontrata është mujore dhe nuk e di se çfarë programi është ai. Rregullimi i trotuarit për këmbësorë a ka garacionë sepse as një muaj dit nuk i ka që është shtruar shikone në foto si është qarë. Si Drejtori e Zhvillimit Ekonomik merr pjesë nëpër takime por nuk shohë diçka që je tu bërë për të mirën e bizneseve të Hanit të Elezit. Si drejtoreshë je qe dy mandate dhe shpresën më të madhe që e kemi në kompaninë “Sharrcem” ty si drejtoreshë nuk di a ke pasur ndonjë takim me përfaqësuesit e kompanisë në mënyrë që me ditë se çfarë të mire ne përfitojmë apo me marr një numër të saktë të bizneseve të komunës së Hanit të Elezit sa operojnë në kompaninë “Sharrcem”. Me sa jam në dioni është një marrëveshje e më hershme që përparsi duhet me pasur vendorët.

**Kryesuesi** thekson:- parafolësi e ka pasur diskutimin dhe në replikë ka shtruar çështje të tjera kështu që ekzekutivi nuk ka nevojë me dhënë përgjigje. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të parapri sipas agjendës.

### 3. Miratimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2019.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Rufki Suma** thekson:-në raport janë të shënuara në mënyrë të detajuara të gjitha gjërat dhe nëse kërkohet ndonjë sqarim apo nëse ka ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Sabedin Hasallari** thekson:- për herë të parë në vitin 2019 ishin inkasuar tatimet në tokë dhe unë e di që prej nivelit qendrorë është kërkuar që kjo hyrë në fuqi në vitin 2020 apo 2021 dhe çka bëhet me ata qytetarë të cilët kanë paguar .

**Rufki Suma** thekson:- faturat që janë shpërndarë prej nivelit qendrorë ka pasur disa paqartësi dhe ka pasur disa gabime dhe nëse ka qenë pronë bujqësore është liruar kurse oborret i kanë llogaritur, dhe nëse shënon zabel është dashur me paguar tatimin.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim rregulloren; rezultati i votimit ishte 11 për 2 kundër (nga opozita). Prezent ishin 13 këshilltarë të kuvendit të komunë.

#### U MIRATUA RAPORTI I SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR VITIN 2019

#### **4. Miratimi i propozim vendimit për rritjen e buxhetit nga të hyrat vetanake për vitin 2019.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Rufki Suma** thekson:- kur kemi tejkalim të buxhetit fillimisht duhet të merret vendim për rritje dhe pastaj të bëhet bartja. Mjetet financiare janë paraparë se në cilën kategori do të shkojnë. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR RRITJEN E BUXHETIT NGA TË HYRAT VETANAKE PËR VITIN 2019.

#### **5. Miratimi i propozim vendimit për bartjen (rialokimi) e buxhetit të paspenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Rufki Suma** thekson:- mjetet financiare që kanë mbetur prej projekteve që ne i kemi planifikuar duhet të barten për shkak se ofertat ishin më të lira dhe i kemi planifikuar se në cilat projekte dedikohen.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 10 për 3 abstenim (nga opozita). Prezent ishin 13 këshilltarë të kuvendit të komunë.

#### **6. Miratimi i propozim vendimit për miratim dhe realizimi të projektit kapital “Kanali i myllur për ujërat atmosferike “ Seqishtë.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Rufki Suma** thekson:- ju e dini që me IPA fondej me komunën e Gazibabës jemi përfitues të një projekti dhe jemi orientuar për projektin rregullimi i e kanalizimit nga Izvorri deri në lumin Lepenc i cili do të jetë i myllur sikur në lagje të re. Projekti do të financohet nga Bashkimi Evropian përmes IPA fondeve. Kërkoj që të përkrahet dhe të miratohet si projekt.

**Akif Shkreta** thekson:- pasi projekti është paraparë që të jetë i myllur për çka do të shfrytëzohet a për çiklizëm apo për këmbësorë. Nëse shfrytëzohet edhe nga mjetet e rënda a ka kapacitete ai kanal apo jo. Gjatë kryerjes së punimeve është mirë që të monitorohet projekti sepse pak është ngushtë dhe do të jetë problem me u pastruar në të ardhmen.

**Florim Shkreta** thekson:- për këtë projekt fillimisht do të ishte mirë që të merret edhe pëlgimi i banorëve sepse më herët kur është iniciuar ky projekt të gjithë banorët e dinë që projekti prej te Izvodi deri nën breg aty ku potenconë ju në plan është planifikuar të jetë i hapur dhe me pasur edhe një trotuar për këmbësorë. Është mirë të bisedohet me fshatarët dhe me banorët për rreth që të jenë në dioni edhe ata e pastaj me ndërmarr diçka.

**Sead Vila** thekson:- u përmendë nga parafolësit fjala Izvorë por unë mendoj që në shumicën e dokumentacioneve i kemi tejkaluar këto terminologji dhe do të ishte mirë që me gjet një terminologji tjetër.

**Florim Shkreta** thekson:- fat që e kemi këtë zërin e popullit që ka dal në këtë pjesën tjetër si opozitë por në fakt nuk e ka vendin këtu por duhet me dal në at pjesën tjetër ose te ekzekutivi dhe forat e zërit të popullit nuk është mirë me i shitë sepse na të paktën i kuptojmë.

**Sead Vila** thekson:-unë jam i zgjedhur prej qytetarëve dhe s'është me rëndësi se ku ulem por çdo gjë që është në interes të qytetarëve edhe kur e ke mirë ty do të përkrahi dhe kur e ke keç nuk do të mbështesë.

**Rufki Suma** thekson:- ka kapacitet sepse është sikur në Lagjë të Re. Ne potencuam që projekti do të jetë i mbyllur dhe në të ardhme mund të vendosim se a do të jetë rrugë apo do të përdoret vetëm për këmbësorët dhe nëse është në pronë publike ne nuk kemi pengesa por nëse kemi të bëjmë me prona private bisedojmë me qytetarë, mirëpo pëlqimet janë dhënë me shkrim të cilët i ka drejtoria e urbanizmit. Pastrimi nuk është problem sepse mund të pastrohet me makineri sikur se është bërë pastrimi në lagje të sepse hapësira e lejon.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 10 për 3 kundër (nga opozita). Prezent ishin 13 këshilltarë të kuvendit të komunë.

#### **U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR MIRATIMIN E REALIMIT TË PROJEKTIT KANALI I MBYLLUR PËR UJËRAT ATMOSFERIKE SEÇISHTË**

##### **7. Miratimi i raportit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2019.**

**Kryesuesi** thekson:- kuvendi i komunës gjatë vitit 2019 ka planifikuar që t'i mbajë dymbëdhjetë mbledhje. Gjatë vitit 2019 ka mbajtur gjithsej dymbëdhjetë mbledhje të rregullta, një mbledhje solemne dhe një mbledhje komemorative. Mbledhjet e kuvendit vazhdimisht janë monitoruar nga monitoruesit e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Vlen të theksohet se në bazë të monitorimit nga përfaqësuesit e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal gjatë vitit 2019 vetëm një rregullore i është kthyer kuvendit të komunës për rishqyrtim (Rregullorja për Transparencë), kurse të gjitha vendimet tjera që janë marr në kuvendin e komunës kanë qenë në përputhshmëri me ligjin. Kuvendi i komunës gjatë vitit 2019 ka miratuar 4 rregullore dhe 42 vendime, që në krahasim me vitin e kaluar ku kuvendi i komunës ka miratuar 40 vendime dhe 3 rregullore. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mefail Suma** thekson:-është bërë një gabim teknik sepse tri herë ishte përsëritur mbledhja e nëntë dhe duhet të përmirësohet.

**Kryesuesi** thekson:-është bërë gabim teknik dhe e përmirësojmë. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Prezent ishin 13 këshilltarë të kuvendit të komunë.

#### **U MIRATUA RAPORTI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2019**

##### **8. Informatë mbi raportin vjetor 2019 të NPL Pastrimi Sh.A.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Kujtim Dernjani** thekson:- materiali është dërguar me kohë dhe përvëç asaj që është përcjellë me shkrim diçka të veçantë nuk kam, nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:- a janë përfshirë në kontratë për bartjen e mbeturinave të gjitha familjet. A janë pajisur me kontinierë të ri familjet të cilat kanë kontratë.

**Florim Shkreta** thekson:- kompania a e ka të shtrirë veprimtarinë e tyre në tërë territorin e komunës së Hanit të Elezit sepse një pesëdhjetë hapa nga baza e kompanisë nuk është pastruar prej mbeturinave të cilin mund ta shihni edhe në foto. Kompania a ju ka borxh punëtorëve të më hershëm.

**Sead Vila** thekson:- sa janë në total ekonomitë familjare , e sa prej tyre janë në sistemin e pagesave dhe sa kanë mbetur pa u përfshirë. A ka kontroll nga inspektorët se ku i hedhin mbeturinat a në zona rurale apo nëpër lumej. A janë të liruara rastet me asistencë sociale nga pagesa.

**Nora Xhoni** thekson:- para dy jave ata të cilët nuk i kanë paguar mbeturinat ua kanë lënë dhë nuk u ka kryer shërbimin kompania. Kërkoi sqarim se a është kryer pagesa që është pastruar tereni apo si është vepruar.

**Sabedin Hasallari** thekson:- shpenzimet për mirëmbajtjen e mjeteve janë rritur dhe bordi i ri i ka ngritur pagat në krahasim me bordin e kaluar. Nëse bordi i ka ngritur pagat për vete ne tu a rritë edhe punëtorëve të tjerë. Punët janë duke u kryer mirë por është mirë që tu kushtohet rëndësi shpenzimeve që me kursyer pak më shumë. Punëtorëve që do tu skadon kontrata a do tu vazhdohet përsëri. Propozoj që bordi ta shqyrton këtë propozim që klientët të cilët janë pagues të rregullt me u pajisur me kese të najllonit sepse është një stimulim që me i nxituar edhe ata të cilët nuk paguajnë.

**Mefail Suma** thekson:- këtu shënon kompani publike, shoqatë aksionare dhe bordi është i përbërë prej katër anëtarëve dhe anëtarë i pestë është kryeshef i ndërmarrjes. Çfarë aksione të përbashkëta ka bordi dhe shoqatën aksionare pastrimi dhe çfarë funksioni kryen .

**Rufki Suma** thekson:- kompania është ndërmarrje publike e themeluar me vendim të Qeverisë së Kosovës dhe është me aksione një qind për qind të komunës. Ligji për shoqëritë aksionare e përcakton që për me u themeluar një shoqëri aksionare duhet t'i ketë organet e veta dhe po që se mos të na kishte obliguar ligji edhe unë nuk kisha lejuar me pasur bord por ligji e precizon që bordi me i pasur pesë anëtarë. Anëtarët e bordit e marrin vetëm një mëditje për mbledhjen që marrin ashtu siç e ka pasur kompani kur është themeluar. Sa i përket ngritjes së pagave për punëtorët ne kemi kërkuar që tu ngitet edhe punëtorëve të kompanisë por për shkak se ligji ende nuk ka hyrë në fuqi nuk janë bërë ngritjet e pagave. Punëtorët të cilët kanë punuar ditën e shtunë dhe të dielën ju është bërë kompensimi i orëve shtesë. Nga momenti që është themeluar kompania lokale Pastrimi nuk i ka borxh asnjë punëtori, mirëpo gjérat janë përzierë për shkak se më herët ka qenë kompani private dhe kompania e cila është themeluar nuk ka obligim që me i paguar punëtorët të cilët nuk kanë qenë të kësaj kompanie. Për vitin 2020 kemi planifikuar afér 20 000 € për me i blerë kontinierët mirëpo këto mjete nuk do të shpenzohen për shkak se kompania është fituese e një donacioni për performancë të mirë nga Gizi dhe ato mjete do të ipen në kontinierë. Janë 1200 ekonomi familjare të cilët kanë nënshkruar kontrata dhe për çdo muaj numri është duke u shtuar. Ata të cilët nuk i kanë paguar mbeturinat kompania nuk ua ka bartur mbeturinat dhe ata i kanë hedhur në vende të ndryshme dhe pastaj i fotografojnë mbeturinat gjoja se kompania nuk është duke i hequr. Qytetarët të cilët i hedhin mbeturinat në vende të ndryshme nëse kemi pas informacione janë dënuar. Shpenzimet për mirëmbajtje janë shtuar për shkak se kamioni i madh ka pas probleme. Katër punëtorë në këtë kompani i kemi pasur nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për gjashtë muaj dhe është vazhduar edhe një herë dhe brenda këtyre ditëve do tu skadon dhe nëse nuk u vazhdohet kompania do të ketë probleme për punëtorë. Në vendet tjera klientët të cilët janë të mirë i stimulon por kompania për momentin nuk i ka ata mundësi. Zyrtarisht rastet sociale nuk janë të liruara, ndoshta mund në aspektin moral mos me i bërë presion ndonjërs prej familje.

**Sevime Laçi** thekson:- a kanë punëtorët dhe anëtarët e kuvendit të komunës të gjithë kontratë me kompaninë Pastrimi për shkak se ne duhet të jemi shembull për me i motivuar të tjerët.

**Kujtim Dernjani** thekson:- punëtorët e administratë shumica kanë kontratë po ashtu edhe anëtarët kuvendit dhe ekzekutiv kanë kontrata dhe i kanë paguar. Mëditjet për bordin e drejtoreve nuk janë rritur por shifrat që janë paraqitur janë se janë bartur prej vitit 2018 për shkak se mbledhjet nuk i kanë paguar.

**Florim Shkreta** thekson:-punëtorët të cilët kanë mbetur pa paguar te Pastërtia kam mëndur që kanë të bëjnë me komunë dhe nuk e kam ditur që ka të bëje me person privat. A keni ndonjë plan për me i paguar ata punëtorë.

**Kujtim Dernjani** thekson:- më vjen keq për ata punëtorë për shkak se ata kanë pasur kontratë me kompaninë dhe mund t'i ndjekin procedurat, kurse sa i përket kompanisë publike nuk kemi pasur problem për pagesën e punëtorëve. Deri më tanë 1225 familje e kanë të nënshkruar kontrata dhe ka mbetur edhe një numër i vogël që nuk kanë kontrata.

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të parapri sipas agjendës.

### 9. Të ndryshme.

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Samire Curri** thekson:- kohët e fundit kemi pasur vazhdimesht ndërprerje të rrymës elektrike dhe nuk kemi pasur vend adekuat që ku të ankohermi për defektet të cilat kanë ndodhë. Më herët ka pasur personel adekuat në kuadër të KEDS-it dhe defektet që ndodhnin në Han të Elezit i rregullonin për një kohë të shkurtë. Propozoj që edhe në Han të Elezit të ketë një zyre dhe personel vendorë në kuadër të KEDS-it që të jetë i pranishëm në komunën tonë. Unë nuk i di kompetencat e KEDS-it si janë për çështje të zyrës dhe kërkoi që të informohemi rrëth kësaj çështje.

**Mefail Suma** thekson:- kam lexuar për raportin e auditorit për komunën për vitin 2018 dhe e ka sugjерuar komunën që në vitin 2019 ta harton regjistrin e pasurisë së komunës. Aty kërkohet regjistër i drejtë dhe i vërtetë. A është bërë ai regjistër sepse prej se ka filluar komuna e Hanit të Elezit e deri më sot ende nuk kemi regjistër të pasurisë. Nëse bëhet regjistri i pasurisë a do të kemi mundësi ne si anëtarë të kuvendit të komunës që ta shohim atë material në mënyrë që ta lexojmë pasurinë e komunës. Kërkoj përgjigje me shkrim për këtë çështje.

**Florim Shkreta** thekson:- kërkoj sqarim për fondin e Sharcemit që është në kuadër të komunës nga kush udhëhiqet , me çfarë kushte ka vepruar ai fond dhe a duhet të jep raport para kuvendit pasi që kryetari i komunës jep raport. Kërkoj përgjigje me shkrim: Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave të QKMF-së dhe Administratës Komunale. Shtrimi me kubëza në zonat rurale dhe urbane. Mirëmbajtja e ndriçimit publik në zonën urbane dhe rurale. Ngritja e pllakave përkujtimore për Dëshmorët për secilën pllak veç e veç. Rregullimi i trotuarit për këmbësor dhe shtigjeve për biçiklistë Dheu i Bardhe – Shfmu “Ilaz Thaci”. Vlerat nënë njëmijë euro me Shërbime të publikimeve në TV dhe web faqe për aktivitetet e komunës TV.Dielli Media. Vlerat nënë njëmijë furnizim me tavolina për SHML “Dardania” . Sa i përket asaj që nuk i jep përgjigjet unë e dijë se që je shef i prokurimit hajnia ekziston këtu. Si shef i prokurimit nëse je i drejtë mund të jepni përgjigje.

**Sead Vila** thekson:- për tatimin në pronë ka pasur shumë gabime në faturat të cilat na janë dërguar për pagesën e tatimit në pronë dhe për vitin 2019 kanë filluar të gjitha kategoritë e pronave me hyjë në sistemin e pagesave, e në diskutim me familjarë vërejta që edhe vet isha i përfshirë që trefishë më ka ardhur më shumë. Kemi parashtruar ankesë dhe anksesa na është kthyer pozitivisht dhe shumë më shumë se dyfishë është reduktuar. Duhet që edhe qytetarëve të tjerë që janë prekur nga këto gabime përvëç shërbimeve duhet tu ofrohen edhe informacione që edhe në forma tjera qytetarët me i paraqitur problemet në mënyrë që me i zgjidhur.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:- drejtoria për shëndetësi a është e përgatitur prej koronavirusit dhe a kanë maska rezerva.

**Rufki Suma** thekson:- që nga dita e parë kemi problem për shkak telefonatave nga ministria të cilët po e urdhërojnë stafin e QKMF-së me dal te kufiri, a në fakt stafi nuk ka asnë pajisje përvëç pajisjeve të rregullta që i ka. Këtë problem e kemi ngritur drejtë për drejtë me ministri por ende nuk ka diçka konkret. Sa i përket tatimit në pronë edhe ne i kemi vërejtur që ka gabime por këta nuk varen prej nesh dhe e vetmja formë për me u përmirësuar është me parashtuar ankesë. Sa i përket fondit të Sharrcemit në momentin që është nënshkruar marrëveshja jemi dakorduar që kompania “Sharrcem” për çdo tre muaj me i ndarë nga 15000 € por asnë herë nuk e kanë bërë dhe komuna ka bërë presion që të shkëputet marrëveshja në fjalë por ende marrëveshja është. Komisioni është dhe zakonisht mjetet financiare janë ndarë për sport dhe kulturë dhe raste të sëmundjeve të rënda. Çështja e ndërprerjes së rrymës është obligim i KEDS-it por sa herë që kemi pasur ndërprerje kam bërë telefonata dhe kam zhvilluar shumë takime me përfaqësuesit e KEDS-it dhe takim kam pasur edhe me drejtorin e KEDS-it për këto probleme. Kemi të gjitha kërkosat që ja kemi përcjell me shkrim që nga viti 2010. Në takimet që kemi pasur përfaqësuesit e KEDS-it kanë deklaruar që i marrin për sipër dy apo tri projekte në këtë vit për me i kryer. Çështjen e mbylljes së zyrës që në atë kohë kemi bërë reagime dhe kemi zhvilluar takim me drejtorin por nuk kemi kompetencë në këtë çështje, e vetmja formë është me protestuar tjetër formë nuk ka.

**Xhevedet Bushi** thekson:- nuk është mirë me paragjykuar sa i përket hajnisë për shkak se hajninë e paraqet raporti i auditorit, lexoni mirë raportet nëse dini me i lexuar dhe vazhdoni siç keni vazhduar më herët nëpër krimë ekonomike sepse e keni testuar veten pesë apo gjashtë herë. Në raport janë të gjitha të paraqitura dhe nuk kam shka të shtojë.

**Florim Shkreta** thekson:- unë e potencova atë fjalë për arsyen se reagimi është për mos me dhënë përgjigje, e nëse jeni në të drejtë dhe i pastër pse me reaguar dhe pse mos me dhënë përgjigje dhe sa i përket asaj që ty je tu dashur me hyjë ka i felli është mirë me ndal veten se në sovranitet të brendshëm me prekur nuk bënë e që besoj që ty e dinë.

**Medina Imishti** thekson:- organizata botërore e shëndetësisë e ka shpallur një gjendje emergjente që kërkon me marr masa parandaluese për mos me ardhur në Kosovë, mirëpo te na instituti i shëndetit publik i ka dërguar disa rekomandime që kërkon me pasur një ekip 24 orë në kufij, me pas një lloj karnatine aty dhe me pasur masa mbrojtëse. Unë kam kërkuar një takim emergjentë në ministri dje kam treguar që zona ku fitare nuk është komunale por shtetërore dhe nuk kemi kapacitet me kryer atë punë të cilën ata e kanë kërkuar. Momentalisht jemi në bashkëpunim me komunën e Ferizajt dhe nga sot do të fillojnë edhe ata me mbajtur një orar nga ora tre deri në ora njëmbëdhjetë sepse po ka qytetarë të huajë të cilët vijnë dhe duhet të kontrollohen. Çështja e masave mbrojtëse është kompetencë e ministrisë me i sjellë dhe ata nuk kanë dërguar asgjë dhe fatkeqësisht edhe termometrin që kushton 25 € nuk e kanë sjellë por e kemi blerë ne si komunë.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen e kuvendorit të komunës. Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 13:30

Procesmbajtësi

Ayni Bushi



Kryesuesi i Kuvendorit

MSc. Qamush Brava